

**VENDIM**  
**Nr. 150, datë 13.3.2024**

**PËR NGARKIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI AUTORITET  
KONTRAKTOR PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “KOLEGJI I EVROPËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese për realizimin e projektit “Kolegji i Evropës” dhe autoritet kontraktor për kryerjen e procedurave të prokurimit publik për hartimin e zbatimin e projektit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke lidhur edhe kontratat përkatëse, si dhe të ndjekë zbatimin e tyre e të projektit.

2. Në funksion të realizimit të projektit sipas pikës 1, Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në përputhje me kërkesat e Kolegjit të Evropës, dhe parashikimet e marrëveshjeve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kolegjit të Evropës, harton programin e zhvillimit dhe ndjek detyrën e projektimit për realizimin e projektit “Kolegji i Evropës”, duke pasur parasysh parashikimet e vendimit nr. 641, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për projektet ‘Ndërtim i kampusit të ri të Universitetit të Tiranës’, ‘Ndërtim i godinave të Universitetit të Arteve të Tiranës’ dhe ‘Ndërtim i Korpusit të Policisë së Shtetit, Policisë Shkencore dhe Akademisë së Sigurisë’”.

3. Projekti zhvillohet në pasurinë (truall) me nr. 5/637, të ndodhur në qytetin e Tiranës, zona kadastrale nr. 8160, nr. faqe 48, nr. vol. 50, të vënë në dispozicion nga Bashkia e Tiranës, sipas vendimit nr. 16, datë 31.1.2024, të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë, “Për dhënien e pëlqimit në parim për zhvillimin e projektit ‘Kolegji i Evropës’, si pjesë integrale e masterplanit të zhvillimit të zonës në pasurinë 5/637, të ndodhur në qytetin e Tiranës, zona kadastrale 8160, nr. faqe 48, nr. vol. 50, në pronësi të Bashkisë së Tiranës”, duke pasur parasysh procedurat e zhvilluara në kuadër të vendimit nr. 641, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për projektet ‘Ndërtim i kampusit të ri të Universitetit të Tiranës’, ‘Ndërtim i godinave të Universitetit të Arteve të Tiranës’ dhe ‘Ndërtim i korpusit të Policisë së Shtetit, Policisë Shkencore dhe Akademisë së Sigurisë’”.

4. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Bashkia Tiranë lidhin marrëveshje bashkëpunimi, në funksion të zhvillimit të projektit, sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe parashikimeve të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kolegjit të Evropës.

5. Fondi Shqiptar i Zhvillimit i paraqet Ministrisë së Financave kërkesën për të hartuar e për të ndërmarrë nismën për alokimin e fondeve të nevojshme për zbatimin e projektit prej tij. Fondi për realizimin e projektit “Kolegji i Evropës” parashikohet në programin “Programe zhvillimi” të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**